



Para-lajmërim i Ftesës për Aplikim në Roundin e 7-të të

Skemës së Celulës së të Rinjëve, Programi i BE-së për bursa post-diplomike 2010

NB: Ky është një para-lajmërim për të informuar lidhur me hapjen e ardhshme të ftesës për aplikim. Tani nuk kërkohet asnjë veprim nga aplikantët potencial.

Zyra Ndërlidhëse e Komisionit European (ZNKE) në Prishtinë dhe **Agjencia për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integritet Evropian (AKZHIE)** në Zyren e Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës, paralajmërojnë hapjen e konkursit për Raundin e 7-të të Skemës së Celulës së të Rinjëve, programi i BE-së për bursa post-diplomike për Kosovën, program i cili është duke u zbatuar nga SOFRECO SA. Aplikimi do të jetë i hapur nga **11 janar 2010** deri më **26 shkurt 2010** dhe kandidatëve të suksesshëm do t'iu ofrohet mundësia të aplikojnë për **Program Master** në univerzitetet të shteteve anëtare të BE-së. Programi i Bursave, **gjuha e punës e së cilës është gjuha angleze**, do të ofroj deri në 42 bursa të plota (numri real i bursave të ofruara mund të jetë më i vogël varësisht nga përshtatshmëria e kandidatëve dhe fondet në dispozicion). Kjo ftesë do të jetë e hapur për studentët e diplomuar në fakultetet si juridik, ekonomik apo/edhe menaxhment, shkenca politike, art dhe literaturë, inxhinieri, gjeologji, miniera, veterinar, nutricion, biologji, kimi apo ndonjë tjetër fushë akademike (siç është specifikuar në Rregullat e Procedurës që do të publikohen më 11 janar 2010) që është në përputhje me sektorët e specializimit në vijim:

- ◇ Juridik (Përafrimi i legjislacionit, të drejtat intelektuale, komerciale dhe industriale, Legjislacioni i BE-së për transport)
- ◇ Makroekonomi dhe Financa Publike
- ◇ Veterinari, Fitosanitari dhe Siguria e Ushqimit
- ◇ Energji, Mjedis dhe Miniera
- ◇ Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore

Të drejtë konkurimi kanë aplikantët të cilët:

- ◇ Posedojnë letërnjoftim dhe/apo Dokument të Udhëtimit të UNMIK-ut të vlefshme apo pasaportë të Kosovës apo letërnjoftim të lëshuar nga Autoritetet e Kosovës
- ◇ Janë të diplomuar në njërin nga fushat e lartpërmendura. Studentët të cilët janë në përfundim të fakultetit poashtu kanë të drejtë **konkurimi nëse marrin diplomën jo më vonë se 30 qershor 2010**.
- ◇ Flasin rrjedhshëm gjuhën angleze dhe shqipe apo serbe. Njohja e gjuhëve tjera të BE-së konsiderohet përparsi.
- ◇ Disponueshmëria për udhëtim nga shtatori 2010
- ◇ Janë lindur më **27 shkurt 1970** apo më vonë

Bursat do të mbulojnë shpenzimet për jo më shumë se **42 bursistë**, si në vijim:

- ◇ Shpenzimet e shkollimit
- ◇ Shpenzimet e jetesës
- ◇ Shpenzimet e vizës
- ◇ Sigurimin shëndetësorë
- ◇ Biletat e udhëtimit
- ◇ Testin e gjuhës Angleze IELTS

Pjesëmarrësit e përzgjedhur do të zotohen të:

- ◇ Punojnë për Qeverinë e Kosovës si praktikant së paku dy muaj para nisjes
- ◇ Ndjekin Programin e Trajnimit të Gjuhës SCR (ku është e nevojshme)
- ◇ Ndjekin dhe kryejnë studimet e zgjedhura post-diplomike
- ◇ Përbushin obligimin e punësimit të pandërprerë trevjeçar në Administratën Publike të Kosovës, pas kthimit

Përzgjedhja do të zhvillohet në tre faza të cilat përfshijnë:

- ◇ Përzgjedhja e CV-ve dhe Letrave të Motivimit
- ◇ Testet me shkrim (i njohjes së gjuhës Angleze, njohjes së përgjithshme për BE-në, vlerësimi verbal dhe numerik)
- ◇ Intervistë nga paneli i akademikëve evropianë dhe përfaqësuesve nga ZKNE dhe AKZHIEI

Femrat dhe përfaqësuesit e minoriteteve fuqimisht inkurajohen të aplikojnë. Formularët e aplikimit dhe dokumentet tjera përcjellëse do të mund të shkarkohen nga interneti, në web faqen vijuese www.ycskosovo.eu duke filluar nga **11 janar 2010**. Informatat shtesë mbi Rregullat e Skemës, Procedurat dhe Kriteret e përzgjedhjes poashtu do të jenë online nga data e njejtë.

Ky është vetëm para-lajmërim për të informuar aplikantët potencial për hapjen e ardhshme të ftesës për aplikim. Aplikimi ende nuk është hapur.

Për më shumë informata www.ycskosovo.eu

Vërejtje: Zbatimi i këtij programi varet nga mundësia e financimit nga BE, menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit European në Kosovë

“Skema e Bursave të BE-së – Raundi VI” është projekt i financuar nga BE, menaxhuar nga ZNKE dhe zbatuar nga SOFRECO SA.

